

VENDIM
Nr. 435, datë 15.7.2021

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “PËR NDËRTIMIN E BANESAVE PËR STREHIM SOCIAL, ROSKOVEC”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për ndërtimin e banesave për strehim social, Roskovec”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Roskovec.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit “tokë truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 741 000 (shtatëqind e dyzet e një mijë) lekësh.

4. Masa e shpërblimit për pronarët që shpronësohen është 741 000 (shtatëqind e dyzet e një mijë) lekë dhe do të përballohet nga Bashkia Roskovec.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga Bashkia Roskovec.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Roskovec.

8. Bashkia Roskovec të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Roskovec.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të nisë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë regjistrimin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe regjistrimi i kalimit të pronësisë në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Roskovec, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**LISTA EMËRORE, PËRFUNDIMTARE, E BASHKËPRONARËVE TË PASURISË, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “PËR NDËRTIMIN E BANESAVE PËR STREHIM SOCIAL, ROSKOVEC”**

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Sip. e prekur truall (m²)	Çmimi për truall (lekë/m²)	Vlera e truallit	Sip. e ndërtesës së prekur	Çmimi i ndërtesës lekë/m²	Vlera e ndërtesës	Vlera totale	Shënime sqaruese
1	Bashkëpronarët: Ilirjan Kongoli, Hajrie Shehu, Ymid Resuli, Mehdije Hoxha, Eqerem Risilia, Kujtim Kryeziu, Xheladin kryeziu, Pranvera Kryeziu, Muharrem Resuli, Et'hem Resuli, Senije Resuli, Umberto Resuli, Rubie Risilia, Jolldiz Bedini	3196	3/294	1500	494	741000	0	30000	0	741000	Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Fier
SHUMA	Vlera totale paraprake			1500		741000	0		0	741000	